

**GJYKATA E QARKUT TË MITROVICËS**  
**P. 26/2011**

**12 nëntor 2012**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Qarkut të Mitrovicës, me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it, Nuno Manuel Ferreira de MADUREIRA, si Kryetar i Trupit Gjykues dhe Gjyqtaret e EULEX-it, Hajnalka Veronika KARPATI dhe Roxana COMSA, si anëtare të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ndërkombëtare Ligjore të EULEX-it, Beti Hohler, si procesmbajtëse, në çështjen penale nr. P. 26/201, kundër:

**1. L.Q.**, djali i F. dhe Z. P., lindur më .. , në fshatin Obranq, Komuna e Podujevës, shqiptar kosovar, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i martuar, në paraburgim që më 7 gusht 2010,

**akuzuar** përmes Aktakuzës nr. PP. 99/2010 të Zyrës së Prokurorisë Publike të Qarkut të Mitrovicës, së datës 2 shkurt 2011, për veprat penale të:

*Vrasje e Rëndë*, sipas Nenit 147, Pika 7) e Kodit Penal të Kosovës (KPK),  
*Pronësia, Kontrolli, Posedimi apo Përdorimi i Paautorizuar i Armëve*, sipas Nenit 328, Paragrafit (2) të KPK, dhe  
*Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm*, sipas Nenit 291, Paragrafit (1) të KPK;

**dhe**

**2. R.P.**, djali i B. dhe B., mbiemri i vajzërisë Z., lindur më .., në Vushtri, banues në Vushtri, shqiptar kosovar, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, i martuar me tri fëmijë,

**akuzuar** përmes Aktakuzës nr. PP. 99/2010 të Zyrës së Prokurorisë Publike të Qarkut të Mitrovicës, së datës 2 shkurt 2011, për veprën penale të:

*Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm*, sipas Nenit 291, Paragrafit (1) të KPK;

*Pas mbajtjes së seancave të gjykimit kryesor*, të gjitha të hapura për publikun, më 6 korrik 2012, 10 korrik 2012, 11 korrik 2012, 17 korrik 2012, 18 korrik 2012, 5 shtator 2012, 2 tetor 2012, 7 nëntor 2012, 8 nëntor 2012 dhe 9 nëntor 2012, në praninë e Prokurorit Publik të EULEX-it, të akuzuarit L.Q. dhe avokatit të tij mbrojtës Rexhep Kaçaniku, të akuzuarit R.P. dhe avokatit të tij mbrojtës Mahmut Halimi, palës së dëmtuar B.L. dhe në seancën e mbajtur më datën 17 korrik 2012, si edhe në praninë e Palës së Dëmtuar A.A.,

*pas* këshillim-votimit të trupit gjykues të mbajtur më datën 12 nëntor 2012,

*sipas* Nenit 392, Paragrafit (1) të Kodit të Proçedurës Penale të Kosovës (KPPK) më 12 nëntor 2012 gjatë një seance të hapur për publikun dhe në praninë e të dy të akuzuarve, avokatëve të tyre mbrojtës, Prokurorit Publik të EULEX-it dhe Palës së Dëmtuar B.L.,

*shpall si në vijim:*

## **AKTGJYKIM**

- I. I akuzuari L.Q.**, djali i F. dhe Z. P., lindur më .., në fshatin Obranq, Komuna e Podujevës, shqiptar kosovar, ka kryer shkollën e mesme, i papunë, i martuar, në paraburgim që më 7 gusht 2010, shpallet

### **FAJTOR**

Sepse është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se më 3 gusht 2010, në fshatin Prekaz, Komuna e Skënderajt, në lagjen Lushtaku, me qëllim dhe duke qenë plotësisht i vetëdijshëm ka privuar nga jeta palën e dëmtuar N.L. Pasi ka marrë premtimin nga H. prej Prishtine që do të merrte 30.000 € (tridhjetë mijë euro) nëse e vriste S.L. nga fshati Prekaz, ai shkoi disa herë në këtë fshat, por nuk mundi ta kryente vrasjen. Në ditën në fjalë, ai shkoi në fshatin Prekaz, duke vozitur automjetin e tij Opel Omega, ngjyë hiri metalike, me numër targe 132-KS-788, i armatosur me një armë automatike AK-47, me numër serie 17077519, dhe me një mitraloz të tipit PPSH, me numër serie 3B-404. Ai shkoi në lagjen Lushtaku dhe e pozicionoi veten pas disa shkurreve të akacias në oborrin e të ndjerit me qëllimin për të vrasur S.L. Sapo një automjet Audi 80 hyri në oborrin e shtëpisë, që vozitej nga N.L., i akuzuari, i bindur që ishte S.L., priti që shoferi të dilte nga makina dhe pastaj qëlloi në drejtim të tij katër herë me mitralozin e tipit PPSH, duke i shkaktuar një plagë hyrëse në syrin e djathtë, një plagë dalëse në pjesën e sipërme të kokës, një plagë hyrëse në anën e djathtë të kraharorit dhe një plagë dalëse në anën e djathtë të kurrizit, një plagë hyrëse në anën e djathtë të kraharorit dhe një plagë dalëse në krahun e djathtë – si pasojë e të cilave viktima vdiq në vendin e ngjarjes. Pastaj, i akuzuari u largua nga vendi i ngjarjes.

**Prandaj, i akuzuari L.Q. DËNOHET për kryerjen e veprës penale të *Vrasjes së Rëndë*, sipas Nenit 147, Pika 7) e KPK.**

- II. I akuzuari shpallet po ashtu**

### **FAJTOR**

Sepse është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se për një periudhë të paditur kohore e deri më 7 gusht 2010, ai me qëllim dhe duke qenë plotësisht i vetëdijshëm ka pasur në posedim, pa lejen përkatëse, një armë automatike AK-47, me 17 plumba të kalibrit 7,62 x 39 mm, dhe një mitraloz të tipit PPSH, me numër serie 3B-404, bashkë me 56 plumba të kalibrit 7,62 mm, dhe e ka përdorur këtë të fundit më datën 3 gusht 2010 për të vrarë N.L.n.

**Prandaj, i akuzuari L.Q. DËNOHET për kryerjen e veprës penale të Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve, sipas Nenit 328, Paragrafit (2) të KPK.**

**III. I akuzuari L.Q., shpallet**

**I PAFAJSHËM**

Sepse nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se më 10 janar 2008, në rrugën “Hafik Zejnullahi”, në Komunën e Vushtrisë, ai i vuri zjarrin automjetit të tipit Mercedes C220 CDI, me numër targe 507-KS-681, pronë e palës së dëmtuar A.A., pas premtimit të R.P.t se ky do t’i paguante atij shumën prej 3.500 € duke marrë një bidon naftë të mbushur me benzinë tek stacioni i petrolit P. dhe duke shkuar pastaj në oborrin e shtëpisë së palës së dëmtuar, aty ku ishte parkuar makina, e duke e spërkatur atë me naftë, duke i vënë zjarrin dhe duke u larguar nga vendi i ngjarjes, duke shkaktuar kështu një rrezik të përgjithshëm.

**Prandaj, i akuzuari L.Q. LIROHET nga kryerja e veprës penale të Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm, (Neni 291, Paragrafi (1) i KPK) sipas Nenit 390, Pika 3) e KPPK.**

**IV. I akuzuari L.Q.**

**DËNOHET**

i.) me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim për veprën penale të *Vrasjes së Rëndë*, sipas Nenit 36, Pika 2) e KPK, Nenit 38 të KPK dhe Nenit 147, Pika 7) të KPK; dhe

ii.) me 4 (katër) vjet burgim për veprën penale të *Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve*, sipas Nenit 36, Pika 2) të KPK, Nenit 38 të KPK dhe Nenit 328, Paragrafi (2) të KPK;

dhe prandaj, në përputhje me Nenin 71, Paragrafi (2), Pika 2) të KPK,

**dënimi unik i caktuar ndaj të akuzuarit është**

## **19 (nëntëmbëdhjetë) vjet burgim**

Koha e kaluar në paraburgim që nga data 7 gusht 2010 do të përlllogaritet në dënimin me burgim, sipas Nenit 73, Paragrafët (1) dhe (4) të KPK.

- V. **I akuzuari R.P.**, djali i B. dhe B., mbiemri i vajzërisë Z., lindur më .., në Vushtri, banues në Vushtri, shqiptar kosovar, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, i martuar me tri fëmijë, shpallet

### **I PAFAJSHËM**

Sepse nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se më 10 janar 2008, në rrugën “Hafik Zejnullahi”, në Komunën e Vushtrisë, ai e ka nxitur kushëririn e tij, L.Q. të kryejë një vepër penale, duke i premtuar atij një shumë prej 3.500 € në shkëmbim për djegien e automjetit të tipit Mercedes C220 CDI, me numër targe 507-KS-681, pronë e palës së dëmtuar A.A.

**Prandaj, i akuzuari R.P. LIROHET nga kryerja e veprës penale të Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm (Neni 291, Paragrafi (1) i KPK) sipas Nenit 390, Pika 3) e KPPK.**

- VI. **Armët dhe municioni** – arma automatike AK-47, me numër serie 17077519 e me 17 plumba të kalibrit 7,62 x 39 mm, dhe mitralozi i tipit PPSH, me numër serie 3B-404 dhe me 56 plumba të kalibrit 7,62 mm - **konfiskohen** sipas Nenit 60, Paragrafit (1) të KPK dhe Nenit 328, Paragrafit (5) të KPK.

**Automjeti Opel Omega** me numër targe 132-KS-788 **konfiskohet** sipas Nenit 60, Paragrafit (1) të KPK.

**Paratë** në shumën prej 3.300,00 EUR, që i përkasin L.Q., **konfiskohen** sipas Nenit 60, Paragrafit (1) të KPK.

- VII. Automjeti Renault Tëingo, me numër targe 539-KS-305, i sekuestruar më 10 janar 2008, i duhet kthyer pronarit të tij të regjistruar.

- VIII. I akuzuari L.Q. do të paguajë 400 (katërqind) Euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale, por nuk është i detyruar të riimbursojë pjesën e mbetur të shpenzimeve, në përputhje me Nenin 102, Paragrafët (1) dhe (4) të KPPK. I akuzuari duhet të riimbursojë shumën e urdhëruar jo më vonë se 30 ditë nga dita kur ky Aktgjykim merr formën e prerë.

Shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 99, Paragrafit (2), Nënparagrafët nga 1) deri në 5) të KPPK, shpenzimet e nevojshme për të akuzuarin R.P. si dhe

kostoja për shpenzimet e avokatit të tij do të paguhen nga burimet buxhetore, në përputhje me Nenin 103, Paragrafin (1) të KPPK.

- IX.** Pala e Lënduar B.L. udhëzohet që mund të proçedojë me padinë e tij pronësore në kontekstin civil, sipas Nenit 112, Paragrafit (2) të KPPK.

## ARSYETIMI

### PROÇEDURA, KOMPETENCA E GJYKATËS, ÇËSHTJET E PROVAVE

#### **1. PREJARDHJA PROÇEDURIALE**

1. Më 3 shkurt 2012, Prokurori Publik i Qarkut i Zyrës së Prokurorisë Publike të Qarkut të Mitrovicës (që këtej e tutje: prokurori publik ose prokuroria) dorëzuan aktakuzën me numër PP. 99/2010 (që këtej e tutje: aktakuza) kundër dy të akuzuarve, L.Q. dhe R.P. I akuzuari Q. është akuzuar se ka kryer veprat penale të *Vrasjes së Rëndë*, sipas Nenit 147, Pika 7) e Kodit Penal të Kosovës (KPK), *Pronësia, Kontrolli, Posedimi apo Përdorimi i Paautorizuar i Armëve*, sipas Nenit 328, Paragrafi (2) të KPK, dhe *Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm*, sipas Nenit 291, Paragrafit (1) të KPK. I akuzuari P. është akuzuar për kryerjen e veprës penale të *Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm*, sipas Nenit 291, Paragrafit (1) të KPK.

2. Më 5 gusht 2011, Gjyqtari Konfirmues i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës e ka konfirmuar aktakuzën në tërësinë e saj.

3. Më 10 shkurt 2012, çështja i kaloi Gjyqtarëve të EULEX-it të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës.

4. Gjykimi kryesor u mbajt me dyer të hapura për publikun, më 6 korrik 2012, 10 korrik 2012, 11 korrik 2012, 17 korrik 2012, 18 korrik 2012, 5 shtator 2012, 2 tetor 2012, 7 nëntor 2012, 8 nëntor 2012 dhe 9 nëntor 2012, në praninë e prokurorit publik, të akuzuarit L.Q. dhe avokatit të tij mbrojtës, Rexhep Kaçaniku, të akuzuarit R.P. dhe avokatit të tij mbrojtës, Mahmut Halimi, palës së dëmtuar B.L. dhe në seancën e datës 17 korrik 2012, po ashtu edhe në praninë e palës së dëmtuar A.A..

#### **2. JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCA**

5. Në bazë të Nenit 23, Paragrafit (1) të KPPK, Gjykatat e Qarkut kanë juridiksionin për të shqyrtuar në shkallën e parë vepra penale të ndëshkueshme me burgim prej të paktën pesë vjetësh ose me burgim afatgjatë. Nëse i njëjti person akuzohet për kryerjen e disa veprave penale të cilat janë subjekt i juridiksionit të gjykatave të ulëta dhe disa janë subjekt i juridiksionit të gjykatave më të larta, sipas Nenit 33, Paragrafit (1) të KPPK, juridiksioni i takon gjykatës më të lartë. Sipas Nenit 33, Paragrafit (3) të KPPK bashkë të

pandehurit, si rregull, janë subjekt i juridiksionit të gjykatës që ka juridiksion për njërin prej tyre.

6. Akuzat në këtë rast kishin të bënin me *Vrasjen e Rëndë*, sipas Nenit 147, Pikës 7) të KPK, që ndëshkohet me burgim prej të paktën dhjetë vjetësh ose me burgim afatgjatë; *Pronësia, Kontrolli, Posedimi apo Përdorimi i Paautorizuar i Armëve*, sipas Nenit 328, Paragrafit (2) të KPK, që ndëshkohet me gjobë ose me burgim nga një deri në dhjetë vjet; dhe *Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm*, sipas Nenit 291, Paragrafit (1) të KPK, që ndëshkohet me burgim prej tri muajsh deri në tri vjet. Prandaj, Gjykata e Qarkut, në përputhje me dispozitat e përmendura më sipër, gëzon juridiksionin në këtë çështje për të gjitha akuzat e aluduara në aktakuzë dhe për të dy të pandehurit.

7. Në bazë të Nenit 27, Paragrafit (1) të KPPK, juridiksioni territorial bie mbi atë gjykatë në qarkun në të cilin aludohet të jetë kryer vepra penale. Sipas aktakuzës, veprat penale kanë ndodhur në vende të cilat bien nën kompetencën territoriale të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, dhe që në fakt janë zona në Komunën e Skënderajt dhe në Komunën e Vushtrisë. Prandaj, në bazë të Nenit 27, Paragrafit (1) të KPPK, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës gëzon juridiksionin territorial për të gjykuar çështjen.

8. Duke marrë në konsideratë vendimin e Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, numër JC/EJU/OPEJ/2662/ff/11, të datës 10 shkurt 2012 dhe në përputhje me Nenin 3.2 të Ligjit mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-053), gjyqtarët e EULEX-it gëzojnë juridiksionin dhe kompetencën mbi çështjen.

9. Gjatë gjithë gjykimit kryesor trupi gjykues ka qenë i përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Nuno Madureira, duke vepruar si Kryetar i Trupit Gjykues, dhe Gjyqtaret e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati dhe Roxana Comsa, si anëtare të trupit gjykues. Që të tri gjyqtarët janë të caktuar në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës. Asnjëra nga palët nuk e kundërshtoi përbërjen e trupit gjykues.

### **3. PROVAT E PARAQITURA**

10. Gjatë zhvillimit të gjykimit kryesor u dëgjuan dëshmitarët e mëposhtëm:

- S.D.më 6 korrik 2012,
- Oficeri i Policisë I.A.më 10 korrik 2012,
- N.L.më 10 korrik 2012,
- B.L.më 10 korrik 2012,
- G.A.më 10 korrik 2012,
- S.L. më 11 korrik 2012,
- Oficeri i Policisë A.P.më 17 korrik 2012,
- Oficeri i Policisë Q.A.më 17 korrik 2012,
- Pala e Dmëtuar A.A. më 17 korrik,
- Oficeri i Policisë H.S.më 5 shtator 2012,
- Oficeri i Policisë V.S.më 5 shtator 2012.

11. Gjatë zhvillimit të gjykimit kryesor u paraqitën provat në vijim:

- Kasete e konfiskuar më 19 nëntor 2010 dhe mikro kasete e dorëzuar nga S.L., Provat 2 dhe 4,
- Njësia e Kriminalistikës PED-OSCIU IT, Raport mbi Ekzaminimin e Provave, të datës 30 gusht 2012, dorëzuar trupit gjykues më 5 shtator 2012,
- Transkripti i Regjistrimeve të datës 1 tetor 2012, bërë nga përkthyesit e EULEX-it në bazë të Urdhrit të trupit gjykues.

12. Gjatë zhvillimit të gjykimit kryesor u lexuan dokumentet e mëposhtme në procesverbal më pëlqimin e palëve:

- Kallëzimin Penal – të dyshuarit: R.P. dhe L.Q., 11/01/2008
- Raport Penal Shtesë, 10/01/2008
- Raporti Fillestar mbi Incidentin, 03/08/2010
- Raport i Ekzaminimit të Vendit të Ngjarjes, Njësia Kriminalistike e PK, 04/08/2010
- Lista e Provave – Kriminalistika e PK, 04/08/2010
- Përmasat e Vendit të Ngjarjes me Skicën e Vendit të Ngjarjes, 03/08/2010
- Album Fotografik – Kriminalistika e PK, 03/08/2010
- Raporti Fillestar mbi Incidentin lidhur me rastin e Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm – Stacioni i PK së Vushtrisë (çështja nr. 2008-BD-0056), 10/01/2008
- Raport i Ekzaminimit të Vendit të Ngjarjes – Rasti i Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm, 11/01/2008
- Arkiva mbi Vendndodhjen e Incidentit (Skica e vizatuar), 10/01/2008
- Album Fotografik – Rasti i Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm, 10/01/2008
- Raportet e Policisë – Oficerët e Policisë A.B. dhe S. S. – Morrën të dhënat mbi trupin e vdekur në Qendrën Shëndetësore të Skënderajt, 04/08/2010
- Raport i Policisë – Oficeri i Policisë F. X., 04/08/2010
- Raport Hetimor – Oficeri i Policisë A. D. – Përshkrimi i Vendit të Ngjarjes, 4/08/2010
- Raport Hetimor – Oficeri i Policisë RCS V.S.– mbi kërkimin për të dyshuarin, 04/08/2010
- Raport Informativ Hetimor – Oficeri i Policisë RCS I.A., 03/08/2010
- Raport Hetimor – Oficerët e Policisë RCS V.S. dhe P. F. lidhur me zhvillimet mbi hetimin e çështjes, 06/08/2010
- Kriminalistika e Policisë së Kosovës – Raport Shtesë mbi armët e gjetura, 07/08/2010
- Raport Hetimor – Oficeri i Policisë RCS V.S.lidhur me njoftimin e prokurorit publik Shyqyri Sylja për Automjetin e Konfiskuar – Opel Omega, 26/05/2010

- Memorandum Ndërzyrtar nga Oficeri Hetues RCS B. G. drejtuar Zyrës së Prokurorisë Publike të Qarkut mbi nxitjen e gjurmëve potenciale (të pazbuluara), 14/01/2008
- Memorandum Ndërzyrtar nga Oficeri Hetues RCS B. G. drejtuar Zyrës së Prokurorisë Publike të Qarkut mbi nxjerrjen e mesazheve SMS, 14/01/2008
- Raport Hetimor– Oficeri i PK H. A. mbi mesazhin kërcënues të marrë nga kolegu i tij i PK, Togeri A.A., 17/01/2008
- Raport i Oficerëve – të PK F. K. dhe B. T. – mesazhi i marrë mbi djegien e automjetit të kolegut të tyre, Togeri A.A., 10/01/2008
- Raport i Oficerëve – Togeri i PK A.A. – lidhur me zjarrvënien e automjetit të tij, 01/10/2008
- Raport i Klinikës së Psikiatrisë mbi gjendjen e Shëndetit Mendor të të pandehurit of defendant L.Q. (DEL 1968), 04/08/2011
- Viktima N.L. – Raporti Fillestar Mjekësor mbi Vdekjen, 03/08/2010
- RCS – Lista e Provave; Zinxhiri Ruajtës, 03/08/2010
- Rezultatet e Ekspertizës së ADN-së nga Qendra Shkencore e Kriminalistikës në Kroaci, 20/12/2010
- Raport i Ekspertizës – ADN – Drejtorja e Laboratorit Kriminalistik të PK, 25/11/2010
- Raporti i Ekspertizës - Armët– Drejtorja e Laboratorit Kriminalistik të PK, 19/10/2010
- Raport i Ekspertizës – ADN – Drejtorja e Laboratorit Kriminalistik të PK, 06.04.2011
- RCS – Lista e Provave; Zinxhiri Ruajtës, 03/08/2010
- Raport mbi Ekzaminimin e Automjetit – Opel Omega, 03/08/2010
- Album Fotografik (ekzaminimi i automjetit) Opel Omega - targa # 132-KS-788, 03/08/2010
- Njësia e Kriminalistikës – Lista e Provave të gjetura në automjetin Opel Omega dhe Lista e Provave të gjetura në shkurret pranë Vushtrisë, 03/08/2010
- Albumi Fotografik i Njesisë së Kriminalistikës – Vendi i Ngjarjes, 03/08/2010
- Memorandum Zyrtar mbi Dorëzimin e Objekteve të Sekuestruara/Gjetura – parave 08/08/2010
- Album Fotografik i Objekteve të Sekuestruara/Gjetura, 08/08/2010
- Memorandum Zyrtar mbi Dorëzimin e Objekteve të Sekuestruara/Gjetura – arma
- Album Fotografik mbi Objektet e Sekuestruara/Gjetura
- Raport mbi Autopsinë – Njësia Kriminalistike e PK – Oficeri i PK Qazim Ahmetaj, 04/08/2010
- Album Fotografik – Fotografitë e Autopsisë, 04/08/2010
- Raporti i Autopsisë së Mjekut Ekzaminues – MA 10 – 216, 04/08/2010
- Fotografitë e Autopsisë së Mjekut Ekzaminues, 04/08/2010
- Formularët e Inventarit të Automjetit, automjeti i të pandehurit Renault Twingo që është konfiskuar, 10/01/2008
- Raport mbi Ekzaminimin e Shenjave të Gishtërinjve – Laboratori i PK, 21/01/2008
- RCS Oficerët e PK – Lista e Provave – viktimja A.A., 10/02/2008



- Prokurori Publik i Qarkut – Proçesverbal i Marrjes në Pyetje të të Pandehurit – L.Q.; Vrasje e Rëndë, Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm, Pronësia, Kontrolli, Posedimi apo Përdorimi i Paautorizuar i Armëve, 05/01/2011
- Policia e Kosovës – Intervistë e të Dyshuarit – L.Q. – Rast Vrasjeje, 07/08/2010
- Policia e Kosovës – Intervistë e të Dyshuarit – L.Q. – Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm, Pronësia, Kontrolli, Posedimi apo Përdorimi i Paautorizuar i Armëve, 12/04/2010
- Policia e Kosovës – Intervistë e të Dyshuarit – L.Q. – rasti i Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm, 10/01/2008
- Prokurori Publik i Qarkut – Proçesverbal i Marrjes në Pyetje të të Pandehurit – R.P. rasti i Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm, 25/10/2010
- Policia e Kosovës – Intervistë e të Dyshuarit – R.P. – Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm, 10/01/2010

#### 4. PËRMBLEDHJA E PROVAVE

13. Dëshmitarët e mëposhtëm dhanë dëshmi lidhur me ngjarjet që pasuan ngritjen e akuzave të *Vrasjes së Rëndë dhe Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve*: S.D., N.L., S.L., I.A., A.P., Q.A.dhe V.S..

14. Dëshmitarët S.D.dhe N.L. ishin të pranishëm në vendin e ngjarjes më 3 gusht 2010, kur u vra viktimja N.L.. Ata dëshmuar lidhur me të shtënat dhe ngjarjet që pasuan, por nuk ishin në gjendje të identifikonin kryesit e veprës penale. N.L. deklaroi se atij i kujtohej, po ashtu, që ta kishte parë automjetin Opel Omega që përputhej me përshkrimin e automjetit të të pandehurit Q. që e tejkaloi automjetin e tij, rrugës për në shtëpi, vetëm disa orë përpara vrasjes.

15. Dëshmitari B.L.dëshmoi për një automjet Opel Omega të parkuar në afërsi të shtëpisë së viktimës mbrëmjen e vrasjes, mes orëve 21.00-22.00. Ai nuk pa ndonjë person në automjet.

16. Dëshmitari S.L. përshkroi në detaje takimin me H.A. në qershor të vitit 2010. H.A., sipas Lushtakut, iu kërkua të merrte pjesë në vrasjen e S.L.t nga një person që quhej L., nga Podujeva. Ai e përshkroi takimin dhe se si e kishte regjistruar atë me zë. S.L. përshkroi më tej historikun e familjes së tij dhe marrëdhënien me ish-kunatin D. L., që aludohet se kishte urdhëruar vrasjen e tij. Gjatë gjykimit kryesor, S.L. po ashtu i paraqiti gjykatës një kopje të regjistrimit me zë të takimit, ndërkohë që ai tashmë e kishte dorëzuar kopjen origjinale në polici, më datën 19 nëntor 2010, gjatë hetimit.<sup>1</sup>

17. Dëshmitarët I.A., A.P., Q.A. dhe V.S. u paraqitën në kapacitetin e tyre si oficerë të Policisë së Kosovës, të përfshirë në hetimin e vrasjes së N.L.t. Ata përshkruan veprimet hetimore që kishin kryer në këtë kapacitet.

<sup>1</sup> Referojuni Faturës së datës 19 nëntor 2010, të dorëzuar gjatë gjykimit kryesor, të shënuar si Prova 3.

18. Dëshmitarët e mëposhtëm dhanë dëshmi lidhur me ngjarjet që çuan në ngritjen e akuzës së *Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm*: G.A., Oficeri i Policisë H.S.dhe Pala e Dëmtuar A.A..

19. Dëshmitarja G.A.ishte e pranishme në shtëpi më datën 10 janar 2008 kur automjeti është djegur dhe ajo ishte në gjendje të shihte automjetin përmes dritares së shtëpisë. Pala e Dëmtuar A.A., i marrë në pyetje si dëshmitar, dëshmoi lidhur me sekuencën e ngjarjeve të mbrëmjes në fjalë. Oficeri i Policisë H.S. ishte në detyrë, së bashku me Palën e Dëmtuar, mbrëmjen që ndodhi ngjarja. Dëshmitari përshkroi veprimet që u ndërmorrën atë mbrëmje, duke përfshirë edhe shiqimin e automjetit Renault.

20. Deklaratat e dëshmitarëve dhe provat përkatëse të dokumentuara do të diskutohen në detaje, më poshtë si pjesë e analizës së provave.

## **5. ÇËSHTJE TË TJERA QË KANË TË BËJNË ME PROVAT DHE PROVAT E SHPALLURA TË PAPANUESHME**

21. Gjatë gjykimit kryesor, trupi gjykues tentoi, po ashtu, të merrte në pyetje edhe K. P., motrën e të akuzuarit R.P., si dëshmitare. Dëshmitarja u paraqit në gjykatë më datën 2 tetor 2012. Dëshmitarja është dëshmitare e privilegjuar, e cila vendosi të përdorte të drejtën e saj për të qëndruar në heshtje, sipas Nenit 160, Paragrafit (1), Nënparagrafit 2) të KPPK dhe si rrjedhojë nuk dha ndonjë deklaratë.

22. Prokurori Publik propozoi që dëshmitari H.A.të merrej në pyetje gjatë gjykimit kryesor. Ky i fundit është identifikuar si një dëshmitar përkatës lidhur me akuzën e *Vrasjes së Rëndë*, kundër të akuzuarit L.Q.; megjithatë, gjykata nuk ishte në gjendje të përcaktonte vendndodhjen e tij, pavarësisht përpjekjeve të ndryshme të trupit gjykues. Në korrik të vitit 2012, trupi gjykues u njoftua se dëshmitari ishte në paraburgim paragyqësor në Belgjikë, dhe për këtë arsye u lëshua menjëherë një Kërkesë për Ndihmesë Ligjore të Ndërsjelltë drejtuar autoriteteve belge. Në shtator të vitit 2012 këta të fundit e njoftuan trupin gjykues se dëshmitari nuk gjendej më në paraburgim dhe se vendndodhja e tij ishte e panjohur. Trupi gjykues kërkoi po ashtu edhe në Policia e Kosovës që të gjente vendndodhjen e dëshmitarit. Policia e Kosovës ktheu përgjigjen se dëshmitari nuk mund të gjendej në Kosovë. Pas kësaj, prokurori publik kërkoi që deklarata e H.A. dhënë përpara Policisë së Kosovës, më datën 4 gusht 2010, të lexohej në proçesverbal, sipas Nenit 368, Paragrafit (1), Pikës (1) së KPPK. Megjithatë, deklarata e konsiderua provë e papranueshme, sipas Nenit 156, Paragrafit (2) të KPPK dhe u përjashtua nga dosja e lëndës (shih më poshtë).

23. Trupi gjykues e përjashtoi si provë të papranueshme deklaratën e dëshmitarit H.A.dhënë Policisë së Kosovës, më datën 4 gusht 2010. Kjo provë u përjashtua në përputhje me Nenin 156, Paragrafin (2) të KPPK, sepse mbrojtjes nuk iu dha mundësia për ta sfiduar deklaratën e dëshmitarit duke e marrë atë në pyetje gjatë gjykimit kryesor ose gjatë ndonjë faze të mëhershme të proçedurës përkatëse penale.

24. Trupi gjykues a hodhi poshtë propozimin e prokurorit publik për të marrë në pyetje F. L., B. L. dhe T. K., si të pabazuar.<sup>2</sup> Të dhënat që mund të siguroheshin nga këta dëshmitarë, sipas këndvështrimit të trupit gjykues, nuk mund të ndriçonin ndonjë fakt material mbi kryerjen e veprës penale dhe rolin e të akuzuarit Q.. Asnjëri nga personat e përmendur nuk aludohej të kishin qenë të pranishëm në kohën e kryerjes së veprës penale apo që të kishin pasur kontakt me të akuzuarin pas vrasjes.

25. Trupi gjykues hodhi poshtë, po ashtu, edhe propozimin e mbrojtjes së R.P.t për të paraqitur prova dokumentuese lidhur me ngritjen e ankesave ndaj A.A.t, si të pabazuara.<sup>3</sup> Dokumentet e sugjeruara kishin lidhje vetëm me faktin e padiskutueshëm, që është ekzistenca e një grindjeje mes familjeve A. e P. Dokumentet nuk mund të shtonin asgjë lidhur me besueshmërinë e dëshmisë së R.P.t si të tillë, siç u debatua nga avokati i tij mbrojtës.

## PËRFUNDIMET E GJYKATËS

### **6. PËRFUNDIMET FAKTIKE TË GJYKATËS**

#### **6.1. Fakte dhe analiza që kanë të bëjnë me veprat penale të Vrasjes së Rëndë dhe Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve (I akuzuari L.Q.)**

*(Faktet e provuara dhe të paprovuara)*

26. Trupi gjykues konsideron që faktet e mëposhtme janë provuar gjatë gjykimit kryesor:

- (1) Përpara datës 3 gusht 2010, H. nga Prishtina i premtoi të pandehurit L.Q. se ai do të merrte 30.000 €(tridhjetë mijë euro) nëse ai do të vriste S.L. nga fshati Prekaz.
- (2) I pandehuri shkoi disa herë në fshat, por nuk pati mundësi ta kryente vrasjen.
- (3) Më datën 3 gusht 2010, i pandehuri L.Q. shkoi në fshatin Prekaz, Komuna e Skënderajit, duke vozitur makinën e tij Opel Omega me ngjyrë metalike, me targën numër 132-KS-788.
- (4) I pandehuri L.Q. ishte i armatosur me një pushkë automatike AK-47, me numër serie 17077519, dhe një mitraloz të tipit PPSH, me numër serie 3B-404.
- (5) Ai shkoi në lagjen e Lushtakëve dhe e pozicionoi veten pas disa shkurreve të dendura të akacies, në oborrin e shtëpisë së N.L.t, me qëllimin për të vranë S.L.
- (6) Sapo automjeti Audi 80 hyri në oborrin e shtëpisë duke u vozitur nga N.L., i akuzuari, duke qenë i bindur se shoferi ishte S.L., priti derisa shoferi të dilte nga makina dhe pastaj qëlloi në drejtim të tij katër herë me mitralozin e tipit PPSH.
- (7) Ai shkaktoi një plagë hyrëse në syrin e tij të djathtë, një plagë dalëse në pjesën e sipërme të kokës, një plagë hyrëse në anën e djathtë të kraharorit dhe një plagë dalëse në anën e djathtë të kurrizit, një plagë hyrëse në anën e djathtë të kraharorit dhe një plagë hyrëse dhe dalëse në krahun e djathtë. Si pasojë e këtyre plagëve N.L. vdiq në vendin e ngjarjes.

<sup>2</sup> Shih Proçesverbalin e Gjykimit Kryesor, seanca e datës 2 tetor 2012, par. 22-30.

<sup>3</sup> Shih Proçesverbalin e Gjykimit Kryesor, seanca e datës 8 nëntor 2012, par. 397-404.

- (8) Pastaj i akuzuari u largua nga vendi i ngjarjes.
- (9) Për një periudhë të panjohur kohore e deri më datën 7 gusht 2010, i pandehuri L.Q. mbajti në posedim, pa leje të vlefshme, armën automatike AK-47 me 17 plumba të kalibrit 7,62 x 39 mm dhe mitralozin e tipit PPSH, me numër serie 3B-404, duke përfshirë 56 plumba të kalibrit 7,62 mm.

27. Trupi gjykues konkludon që nuk është provuar që L.Q. ka vepruar në bashkë-kryerje me A. N. nga Ferizaji.

*(Analizë)*

28. Është e pakundërshtueshme që N.L. është vrarë më datën 3 gusht 2010, pasi është kthyer në shtëpinë e tij në lagjen Lushtaku, në fshatin Prekaz. Ai po voziste automjetin edhe me dy pasagjerë të tjerë në të, dhe kur hyri në oborrin e shtëpisë së tij dhe doli nga automjeti, u qëllua disa herë. Dëshmitarja S.D., e cila ishte në makinë në atë kohë, e konfirmon këtë version të ngjarjeve. Pas të shtënave, vëllai i viktimës, N.L. doli jashtë ku e gjeti viktimën përtokë të mbuluar nga gjaku. Ai e futi viktimën në makinë dhe voziti deri në spitalin në Skënderaj. Ashtu siç konfirmohet nga Raporti Fillestar Mjekësor, që mban datën 3 gusht 2010, viktimja kishte vdekur kur u soll në spital.<sup>4</sup> Autopsia e kryer në trupin e N.L.t, në mënyrë vendimtare përcakton se ai vdiq për shkak të lëndimeve të shumta të shkaktuara nga armët e zjarrit. Përveç të tjerave, viktimja kishte marrë një plagë hyrëse në syrin e tij të djathtë, një plagë dalëse në pjesën e sipërme të kokës, një plagë hyrëse në pjesën e djathtë të kraharorit dhe një plagë dalëse në anën e djathtë të kurrizit, një plagë hyrëse në anën e djathtë të kraharorit dhe një plagë hyrëse e një dalëse në krahun e tij të djathtë. Trupi gjykues i referohet Raportit të Autopsisë të hartuar më datën 5 gusht 2010 dhe Raportit të Autopsisë MA 10-216, të datës 4 gusht 2010.<sup>5</sup> Hetuesit në vendin e ngjarjes, menjëherë pas vrasjes më datën 3 gusht 2010, arritën të gjenin 4 gëzhoja të kalibrit 7,62mmx25mm.<sup>6</sup>

29. Është po ashtu e pakundërshtueshme se i akuzuari voziti automjetin e tij me ngjyrë gri metalike Opel Omega, me numër targe 132-KS-788, në fshatin Prekaz, Komuna e Skënderajt në natën e vrasjes. Vetë i akuzuari e ka pranuar këtë në të gjitha deklaratat e tij. Prania e të akuzuarit në fshat më datën 3 gusht 2010 përcaktohet edhe më tej nëpërmjet dëshmive të N.L.t dhe B.L., ku që të dy e kanë parë automjetin e të pandehurit, Opel Omega me ngjyrë gri metalike në ditën kritike.

30. Është po ashtu e pakundërshtueshme që i akuzuari Q. i udhëhoqi hetuesit e policisë në vendin e armës, me të cilën ishte kryer vrasja e N.L.t. Policia gjeti dy armë, duke u bazuar në të dhënat e siguruar nga i akuzuari, saktësisht në vendin që kishte përmendur ai. Arma e parë ishte një pushkë automatike, AK-47, me numër serie 17077519 dhe një krehër fishekësh me 17 plumba të kalibrit 7,62 mmx39mm. Arma e dytë ishte një

<sup>4</sup> Shih Dosjen e Gjykatës 1, Treguesi II, fq. 14-15.

<sup>5</sup> Shih Raportin e Autopsisë të hartuar më 5.08.2010, Dosja e Gjykatës 1, fq. 107-121 dhe Raportin e Autopsisë MA 10-216, të datës 4.08.2010, Dosja e Gjykatës 1, fq. 122-130.

<sup>6</sup> Raporti i Ekzaminimit të Vendit të Ngjarjes, Njësia e Kriminalistikës, i datës 3 gusht 2010, Dosja e Gjykatës 1, Treguesi II, fq. 74-81.

mitraloz i lehtë, i tipit PPSH, me numër serie 3B 404 dhe një karikator me 56 plumba të kalibrit 7,62mmx25mm. Që të dyja armët u gjetën në fshatin Galicë, pranë rrugës kryesore Skënderaj – Vushtri.

31. Analizat e Ekspertëve të kryera nga Drejtoria e Laboratorit Kriminalistik, përcaktuan se katër gëzhojat, pjesë të plumbave të kalibrit 7,62mmx25mm, të gjetura në vendin e ngjarjes më datën 3 gusht 2010 dhe të shënuara në vendin e ngjarjes si D2, D3, D4 dhe D13 ishin shtënë nga mitralozi i përmendur i tipit PPSH, me numër serie 3B 404.<sup>7</sup>

32. I akuzuari Q. u morn ë pyetje tri herë lidhur me vrasjen e N.L.t gjatë zhvillimit të kësaj procedure penale, më saktësisht më datën 7 gusht 2010, 5 janar 2011 dhe gjatë gjykimit kryesor, më datën 7 nëntor 2012.

33. Në deklaratën e tij fillestare të datës 7 gusht 2010, menjëherë pas arrestimit të tij, i akuzuari deklaroi se para tri muajsh ai kishte takuar një person me emrin Hashim nga Prishtina që e kishte njohur nga Sllovakia. Ky i fundit i ofroi atij 30.000,00 euro për vrasjen e një personi që quhej S. nga Prekazi. Ai i tha atij se S. punonte si kuzhinier në kuzhinën e Kompanisë së Ferronikelit dhe se ai udhëtonte çdo ditë nga Prekazi në Ferronikel rreth orës 5.30 të mëngjesit. Që nga ajo ditë (i akuzuari) shonte në Prekaz dy herë në ditë përpara orës 5.00 të mëngjesit dhe priste për Sabitin. Ai udhëtonte atje me makinën e tij Audi 80 deri sa e ndryshoi makinën në Opel Omega. Në fillim, në makinën e bardhë Audi, ai mbante një Kalashnikov. Një ditë ai u ndalua nga policia që ia sekuestroi armën. Pastaj H. i bleu atij Kalashnikovë të rinj. Tri ditë përpara vrasjes së N.L.t, H. solli në takim me të akuzuarin një person nga Ferizaji dhe e prezantoi atë si A. Një ditë përpara vrasjes, në mëngjes, A. dhe i akuzuari shkuan në fshatin Prekaz dhe pritën për S., por ai nuk doli jashtë atë mëngjes. Prandaj, ata u kthyen të nesërmen. Ata e panë portën të hapur, makina nuk ishte në shtëpi. Pastaj ata u fshehën nëpër disa shkurre akacieje dhe pas një farë kohe – arriti makina Audi 80. Ishte errësirë dhe ishte ora mes 22.00 dhe 23.00. Në makinë kishte dy gra dhe një burrë. I akuzuari ishte tek porta, rreth 7-8 hapa larg makinës Audi dhe kishte në duar Kalashnikovin AK-47, ndërsa A. shkoi duke ndjekur pas makinën deri sa ajo ndaloi nga ana e pasme. Ai kishte një armë dhe menjëherë u dëgjuan katër apo pesë të shtëna. I akuzuari dhe A. u larguan menjëherë me makinë nga vendi. Rrugës ata arritën në një vend ku i lanë të dyja armët. Të nesërmen, i akuzuari i telefonoi H.t dhe i tha atij se çështja për të cilën kishin biseduar ishte zgjidhur. Të nesërmen, H. i telefonoi atij duke i thënë se në vend të personit të duhur ishte vrarë dikush tjetër.

34. Kur u mor në pyetje nga prokurori publik më datën 5 janar 2011, i akuzuari dha një deklaratë mjaft të ndryshme. Tani ai deklaroi se se ditën në fjalë ai shkoi të vriste Sabitin dhe se ai ishte me A. nga Ferizaji vetëm si shofer taksie. Ai deklaroi, po ashtu, se H. priti për A. për rreth 20 minuta, deri sa ky i fundit e kreu vrasjen. Ai i pa armët për herë të parë kur i solli A. në makinë. Pasi u krye vrasja, ata u kthyen në Prishtinë dhe rrugës, afër fshatit Duboc, nën presionin e A., ai e mori armën automatike dhe A. mori armën tjetër dhe i hodhën ato në pyll. Ishte aty ku ai e dëgjoi A. të thoshte se kjo natë e kishte paguar

---

<sup>7</sup> Raport i Analizës së Ekspertit, Drejtoria e Laboratorit Kriminalistik, përfunduar më 19 tetor 2010, Dosja e Gjykatës 1, Treguesi II, fq. 31.

veten dhe se ai kishte fituar 30.000,00 euro. Kur u përball me përmbajtjen e deklaratës që kishte dhënë më datën 7 gusht 2010, i akuzuari tha se ai ishte rrahur dhe ishte detyruar nga policia të rrëfente gjërat që nuk kishte bërë. Për më tepër, i akuzuari u pyet nëse kishte folur me ndonjë njeri lidhur me ndjekjen e Sabitit dhe vrasjen e tij. Ai tha se e kishte diskutuar atë me H.A. nga Skënderaj. Deklarata e tij e mëtejshme lidhur me këtë, fjalë për fjalë, lexon si në vijim: “Unë i thashë atij se ai duhet të siguronte 10.000,00 euro nëse donte të vriste S., por unë i kërkova atij të më ndihmonte dhe të identifikonte S.”.

35. Gjatë gjykimit kryesor i akuzuari nuk dha deklaratë, por iu përgjigj pyetjeve nga palët dhe trupi gjykues. I akuzuari deklaroi se ai ishte vetëm taksisti për një person të quajtur A., të cilin D. L. ‘e futi’ në taksinë e tij. Ai voziti në Skënderaj dhe parkoi atje, ndërsa A. u largua nga makina, duke mbajtur një çantë. I akuzuari dëgjoi muzikë në makinë dhe nuk dëgjoi ndonjë të shtënë. A. u kthye pas nja 20 minutash me një armë në dorë dhe me një armë tjetër në çantë. Ai nuk mund të shihte nëse A. po ecte apo po vraponte. Në kthim, A. e detyroi atë të ndalonte dhe të hidhte armët nën presion. Tani i akuzuari deklaroi, po ashtu, se D. L. dhe personi të cilit ai më herët iu referua si ‘H. nga Prishtina’ janë një i njëjti person. Për më tepër, i akuzuari deklaroi se nuk e dinte ku ndodhej shtëpia e S.L. dhe se ai mësoi për të vetëm gjatë gjykimit kryesor. Kur u përball me mospërputhjet mes përgjigjeve të tanishme dhe deklaratave të dhëna më parë, në veçanti deklaratën e datës 7 gusht 2010, i akuzuari nuk ishte në gjendje të jepte ndonjë shpjegim të kuptueshëm për këto mospërputhje. Fillimisht ai deklaroi se ndaj tij ishte ushtruar presion dhe se nuk kishte pasur avokat të pranishëm, por kur iu tha se avokati i tij *kishte qenë* i pranishëm, ai pranoi se mund ta kishte ngatërruar këtë marrje në pyetje dhe ushtrimin e presionit me një rast tjetër.<sup>8</sup> I akuzuari deklaroi, po ashtu, se ai nuk kishte folur kurrë me H.A. lidhur me ndonjë kontratë vrasjeje.

36. Në këtë moment, trupi gjykues vë re se është përcaktuar që S.L. është fqinji i afërt i N.L.t, siç konfirmohet nga dëshmia e dëshmitares S.D.,<sup>9</sup> dhe dëshmitarit S.L.,<sup>10</sup> dhe nga skica e vendit të ngjarjes.<sup>11</sup>

37. Siç është theksuar më sipër, çdo herë që është marrë në pyetje, i akuzuari ka dhënë një version të ndryshëm të asaj që ka ndodhur më datën 3 gusht 2010 dhe në veçanti për rolin e tij në ngjarje. Në deklaratën e tij fillestare, i akuzuari pranoi se kishte rënë dakort me H.n nga Prishtina për të vrarë S.L. për 30.000,00 euro; ai pranoi ta kishte ndjekur atë për një periudhë më të gjatë kohore dhe se më datën 3 gusht 2010, duke u fshehur përpara asaj (që ai mendoi se ishte shtëpia e tij) me një armë për ta vrarë. Në deklaratën e tij fillestare, i akuzuari paraqiti, po ashtu, detaje të tilla lidhur me personin që ishte edhe shënjestra e sulmit, S.L. dhe rutinën e tij të përditshme, kryesisht që ai shkon në punë herët çdo mëngjes në orën 5.00 dhe që punon në Kompaninë e Ferronikelit. S.L., kur është marrë në pyetje si dëshmitar, e ka konfirmuar këtë të dhënë. Po ashtu, me saktësi, në deklaratën e tij fillestare i akuzuari ka treguar se ai ishte fshehur në pemët e akacias dhe ka përshkruar me saktësi automjetin e vozitur nga viktima natën e vrasjes – Audi 80 – dhe faktin që në makinë kishte edhe dy pasagjerë të tjerë të cilët ishin të pranishëm në

<sup>8</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, seanca e datës 7 nëntor 2012, par. 148-154.

<sup>9</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, seanca e datës 6 korrik 2012, par. 155-156.

<sup>10</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, seanca e datës 11 korrik 2012, par. 128-129.

<sup>11</sup> Dosja e Gjykatës 1, Treguesi I, fq. 87.

vendin e ngjarjes. Trupi gjykues se vetëm i akuzuari mund t'i dinte të gjitha këto, nëse në fakt ai ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes, duke vrojtuar shtëpinë dhe automjetin e viktimës. Në deklaratat e tij të mëvonshme, i akuzuari e ka tërhequr pjesërisht deklaratën e tij dhe ka deklaruar se ai ka qenë vetëm një shofer taksie për A. dhe se ai nuk iu afrua kurrë shtëpisë dhe se nuk kishte dëgjuar për S.L.

38. Trupi gjykues konsideron se deklarata fillestare e të akuzuarit, e dhënë më datën 7 gusht 2010 është më e besueshmja nga të trija. Kjo ishte deklarata e parë e të akuzuarit që ai ka dhënë menjëherë pas arrestimit të tij. Duke pasur parasysh afërsinë e ngjarjes kritike (vetëm disa ditë përpara kësaj) dhe mungesën e kohës për të hartuar një version të ndryshëm, kjo deklaratë konsiderohet të jetë deklarata më e saktë nga trupi gjykues. Për më tepër, deklarata jep një përshkrim të llogjikshëm dhe të detajuar të ngjarjeve, të cilat mbështeten edhe me prova të tjera, ndërsa deklaratat e mëvonshme të të akuzuarit, nuk mbështeten nga asnjë provë tjetër. Për shembull, në deklaratën e tij fillestare i akuzuari ka përshkruar rutinën e S.L.t. Më tej, ai ka përshkruar me saktësi automjetin e viktimës dhe pasagjerët në automjet, si edhe vendndodhjen e shtëpisë dhe pemët rrethonjëse të akacias. Ai i ka bërë, po ashtu, referencë 4-5 të shtënave të qitura, po ashtu si edhe dëshmitarët S.D.dhe N.L..

39. Trupi gjykues është i kënaqur se i akuzuari ka qenë me të vërtetë në oborrin e shtëpisë së N.L.t (duke menduar se ishte shtëpia e S.L.t) dhe se nuk ka qenë i ulur në makinë kur ka ndodhur vrasja, siç deklaroi ai më vonë. Përfundimi mbështetet nga dëshmitari B. L., që e ka parë automjetin e të akuzuarit të parkuar natën e vrasjes, afërsisht mes orës 21.00 dhe 22.00, por nuk pa njeri në makinë. Dëshmitari e përshkroi automjetin si Opel Omega, në ngjyrë hiri të errët, me drita të pasme të thyera, që përputhet tërësisht me automjetin e të akuzuarit, siç shihet nga fotografia nr. 4 e Albumit Fotografik të datës 10 gusht 2010.<sup>12</sup>

40. Ajo që duhet të adresonte më pas trupi gjykues, ishte deklarata e të akuzuarit se, edhe sipas deklaratës së tij fillestare, ai ishte përpara shtëpisë së Lushtakut me A. nga Ferizaji. I akuzuari, madje edhe në deklaratën e tij fillestare, nuk e ka pranuar kurrë të ketë qëlluar mbi N.L.n, por ka deklaruar se ai kishte qenë me një person të aluduar të quajtur A. dhe tha se ishte ky i fundit që e qëlloi viktimën. Ai deklaroi se ai po mbante pushkën AK 47, ndërsa A. po mbante mitralozin.

41. Trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk ka asnjë provë askund në dosjen e lëndës që të tregojë që një person i dytë, të cilit i akuzuari i referohet si A. nga Ferizaji, në fakt ekziston. Prandaj, është përfundimi i trupit gjykues se ekzistenca e këtij personi dhe deklarata që ishte ai që e ka qëlluar N.L.n, është thjeshtë një strategji mbrojtjeje e të akuzuarit.

42. Trupi gjykues vë re se dëshmitarja S.D. pa vetëm një person të vraponte duke u larguar nga vendi i ngjarjes, natën e vrasjes. Për më tepër, dëshmitari N.L. natën e vrasjes pa makinën e të akuzuarit (duke përmendur përsëri dritat e pasme që nuk punonin) që e tejkaloi atë dhe pa vetëm një person në makinë. Për më tepër, i akuzuari nuk ishte në gjendje të jepte ndonjë informacion tjetër lidhur me personin e aluduar A. nga Ferizaj,

---

<sup>12</sup> Dosja e Gjykatës 1, Treguesi II, fq. 52.

dhe as që ishte në gjendje të identifikonte ndonjë dëshmitar që mund të konfirmonte ekzistencën e tij. Nëse personi do të kishte ekzistuar dhe nëse i akuzuari do të kishte paraqitur më shumë të dhëna, duke konsideruar që kjo ishte në interes të tij. Trupi gjykues, po ashtu, vë re se policia, duke u bazuar në deklaratat e të akuzuarit, u përpoq që ta gjente edhe vendndodhjen e këtij personit të aluduar A., por nuk qenë në gjendje ta bënë një gjë të tillë. Po ashtu, sjellja e personit të aluduar A., ashtu siç e përshkruan i akuzuari, është krejtësisht e pallogjikshme, duke konfirmuar në këtë mënyrë pozicionin e trupit gjykues, që A. nuk ekziston dhe se nuk ka pasur person të dytë në vendin e ngjarjes. Fillimisht A. nuk do të fshihej për të ekspozuar më pas papritur armët e vrasjes, nëse ai ishte me të vërtetë vrasësi dhe në këtë mënyrë do të kishte një shtysë të fuqishme për të mos e zbuluar veten si të tillë. Po ashtu, ai nuk do t'i tregonte të akuzuarit se ku do t'i fshihte armët e vrasjes.

43. Prandaj trupi gjykues konkludon se i akuzuari ka vepruar i vetëm dhe se ka qenë ai që ka qëlluar mbi N.L.n, më datën 3 gusht 2010, dhe e ka vranë atë në oborrin e shtëpisë së tij në lagjen Lushtaku, në fshatin Prekaz. I akuzuari ishte i armatosur me dy armë, një armë automatike AK-47, me numër serie 17077519, dhe me një mitraloz të tipit PPSH, me numër serie 3B-404. Ai shtiu mbi viktimën me armën e fundit, duke shkaktuar disa plagë hyrëse dhe dalëse tek viktima, të cilat çuan në vdekjen e viktimës. I akuzuari i fshehu armët më vonë. Që të dyja armët u gjendën më pas në vendin që i akuzuari i kishte dhënë policisë.

44. Mbrojtja debatoi se nuk mund të arrihet në përfundimin që i akuzuari ka qenë në posedim të armës së vrasjes, mitralozit të lehtë, me numër serie 3B-404, pa u mbështetur në ndonjë provë kriminalistike.<sup>13</sup> Trupi gjykues e hedh poshtë një interpretim të tillë. Edhe në mungesë të provave kriminalistike, fakti që i akuzuari ka qenë në posedim të armës mund të bazohet në ekzistencën e provave të tjera. Është vetëm i akuzuari që aludon se arma e vrasjes ka qenë në duart e personit të aluduar A.. Siç është aluduar më sipër, prania e A. dhe me të vërtetë ekzistenca e tij nuk është mbështetur nga asnjë provë e vetme, prandaj trupi gjykues nuk e beson këtë strategji të debatit të të akuzuarit. Megjithatë, duke u bazuar në përshkrimin e detajuar të ngjarjeve të datës 3 gusht 2010 (në deklaratën e tij fillestare të datës 7 gusht 2010) është përcaktuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari *ka qenë* në vendin e ngjarjes dhe se është i vetmi përfundim i llogjikshëm që ka qenë ai që ka shtënë dhe ka vranë N.L.. Një nga provat më bindëse që e mbështet këtë version është fakti që dëshmitarja S. D. pa vetëm një person duke u larguar me vrap nga vendi i ngjarjes, p.sh. të akuzuarin. Nëse do të kishte pasur edhe një person tjetër të pranishëm, dëshmitarja do të kishte parë dy persona duke u larguar nga vendi i ngjarjes. Një provë tjetër e fuqishme është që i akuzuari e dinte vendin e armës së vrasjes.

45. Në fjalën e saj përfundimtare, mbrojtja ngriti çështjen se si ishte në gjendje policia të identifikonte dhe të përcaktonte vendndodhjen e automjetit të të akuzuarit, Opel Omega. Mbrojtja iu referua dëshmive të oficerëve të policisë, të cilët nuk ishin në gjendje të deklaronin saktësisht se nga iu kishte ardhur informacioni për automjetin. Megjithatë, trupi gjykues e konsideron këtë argument të pavlerë, meqenëse fakti që i akuzuari me

---

<sup>13</sup> Shih Fjalën Përfundimtare të avokatit mbrojtës, Rexhep Kacaniku, e cila i është bashkëngjitur procesverbalit të Gjykimit Kryesor, të seancës së datës 9 nëntor 2012.



automjetin e tij kanë qenë të pranishëm në fshat natën e vrasjes është i pakundërshtueshëm. I akuzuari në të gjitha deklaratat e tij e vendos veten e tij dhe makinën e tij atje natën kritike.

46. Trupi gjykues, po ashtu, ka përcaktuar përtej dyshimit të arsyeshëm se shënjestra e vrasjes në fakt nuk ka qenë viktima – N.L. – por fqinji i tij, S.L.

47. Trupi gjykues i bën referencë deklaratës së parë të të akuzuarit, të datës 7 gusht 2010, në të cilën i akuzuari përshkruan se atij iu afrua një person me emrin H. nga Prishtina dhe i premtoi 30.000,00 euro për të vrarë një burrë të quajtur S. nga Prekazi që punonte për Kompaninë Ferronikel. Më vonë, i akuzuari ka deklaruar se H. nga Prishtina është në fakt D. L. dhe se ky i fundit është ish-dhëndri i S. Ai e donte S. të vrarë, sepse vazhdimisht S. ‘e godiste me thikë gruan e tij dhe H.n në Austri’.

48. Personi që është diskutuar është qartësisht S.L., i cili me të vërtetë punonte për Kompaninë e Ferronikelit, dhe që është ish-dhëndri i D.L., që ka jetuar në Austri dhe që është akuzuar se ka goditur me thikë D. L. S.L. e ka konfirmuar të gjithë këtë kur është marrë në pyetje si dëshmitar gjatë gjykimit kryesor.

49. Më tej, S.L. ka përshkruar një takim me H. A., i cili i tregoi atij për vrasjen e porositur. Trupi gjykues vë re se i akuzuari Q. në deklaratën e tij të dhënë më datën 5 janar 2011 ka pranuar se i ka thënë H.A. për vrasjen e porositur të S.L.t.

50. S.L. ka përshkruar një takim në qershor të vitit 2010 që ai ka zhvilluar me H. A., kur ky i fundit i ka thënë atij se atij i kishte ardhur një person i quajtur Luta, nga Podujeva që të merrte pjesë në vrasjen e S.L.. Trupi gjykues konkludon se dëshmia e dëshmitarit S.L. është krejtësisht e besueshme. Dëshmitari ka dhënë një deklaratë të qartë e të llogjikshme, e cila pjesërisht mbështetet edhe nga prova të tjera. Trupi gjykues arrin në përfundimin se përmendja e Lutës nga Podujeva duhet t’i referohet të akuzuarit. Ai me të vërtetë është nga Podujeva dhe ‘L.’ mund të konsiderohet si një pseudonim për ‘L.’, emrin e të akuzuarit. S.L. ka deklaruar, po ashtu, se H.A.i kishte thënë atij se D. L. i kishte dhënë Lutës nga Podujeva një sasi të caktuar parash për të kryer vrasjen. Dëshmitari N.L. e konfirmoi takimin mes S.L.t dhe H.A., por ai nuk pati mundësi të dëgjonte përmbajtjen e vetë bisedës.

51. S.L. e regjistroi me zë takimin me H. A. Ai ia dha regjistrimin original policisë më datën 19 nëntor 2010 dhe dorëzoi një kopje të materialit gjatë gjykimit kryesor. Trupi gjykues dha urdhër për një raport mbi provën, me qëllim që të dëgjohej dhe të riprodhohej përmbajtja e regjistrimit. Prokuroria, në senacën e datës 5 shtator 2012 paraqiti Raportin mbi Shqyrtimin e Provës që ishte urdhëruar (Prova 5).<sup>14</sup> Sipas raportit, zërat në regjistrim ishin shumë të dobët. Prandaj, trupi gjykues i udhëzoi më tej përkthyesit dy përkthyes të EULEX-it ta dëgjonin regjistrimin, me qëllimin e paraqitjes së transkriptit, pavarësisht faktit se sa i plotë ose jo do të ishte ai. Përkthyesit e dorëzuan transkriptin më datën 1 tetor 2012.<sup>15</sup> Megjithatë, ata patën mundësi të konfirmonin vetëm

<sup>14</sup> Raport mbi Shqyrtimin e Provës, i datës 30 gusht 2012, shënuar si Prova 5, Dosja e Gjykatës 2.

<sup>15</sup> Transkriptim i Regjistrimit, dorëzuar në Gjykatë më datën 1 tetor 2012, Dosja e Gjykatës 3.

pjesë të vogla të bisedës, duke e kthyer kështu këtë provë në një provë me vlerë të vogël provuese. Megjithatë, trupi gjykues vë re se emri L. dhe L. përmendet në transkriptin e paraqitur nga regjistrimi.

52. Trupi gjykues, po ashtu, konsideron se periudha kohore e vrasjes së porositur e krahasuar me deklaratën e të akuzuarit dhe deklaratën e S.L.t është në veçanti relevante. I akuzuari, në deklaratën e tij të datës 7 gusht 2010, ka deklaruar se atij i ishin afruar afërsisht tri muaj përpara se të ndodhte vrasja lidhur me të. S.L. u takua me H. A., i cili i tregoi atij për vrasjen e porositur në qershor të vitit 2010. Më tej, në deklaratën e tij të datës 12 prill 2010, (kur është marrë në pyetje lidhur me veprën penale të *Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm*), i akuzuari ka deklaruar se ai ishte ndaluar nga policia dhe se i ishte konfiskuar një pushkë automatike. Ai e ka përsëritur të njëjtën gjë në deklaratën e tij të datës 7 gusht 2010, duke deklaruar se ai ishte ndaluar nga policia në fshatin Dubovc dhe se ata gjetën dhe sekuestruan një Kallashnikov.

53. Prova e mësipërme, po ashtu, konfirmon se i akuzuari e kishte planifikuar vrasjen prej një kohe, duke e kërkuar S.L.. Vetë i akuzuari e deklaroi këtë dhe përshkruan veprimet e tij në deklaratën e datës 7 gusht 2010, duke thënë, mes të tjerash, që qëkur ai “ishte informuar për çështjen”, ai shkoi në Prekaz dy herë në javë dhe priste për S.L..

54. Trupi gjykues e drejton vëmendjen edhe tek provat e tjera, që i akuzuari ishte kontraktuar dhe paguar për vrasjen. Kur është arrestuar, vetëm katër ditë pas vrasjes, shuma prej 3300,00 eurosh iu sekuestrua përkohësisht nga policia. Kur është pyetur për paratë gjatë kësaj çështjeje penale, i akuzuari ka dhënë dy përgjigje krejtësisht të ndryshme. Në deklaratën e tij të dhënë më datën 7 gusht 2010, i akuzuari ka deklaruar se paratë ia kishte dërguar shoku i tij, Qerim Krasniqi nga Sllovakia, ndërsa në deklaratën e dhënë gjatë gjykimit kryesor, i akuzuari ka thënë se paratë ishin rrjedhojë e shitjes së traktorit të familjes. Trupi gjykues nuk i konsideron asnjërën nga deklaratat të besueshme, duke pasur parasysh veçanërisht se ato janë krejtësisht të ndryshme. Trupi gjykues konsideron se në mungesë të një shpjegimi të besueshëm dhe të ndonjë prove mbështetëse, dhe duke pasur parasysh provat e tjera të shumta, përveç pranimit nga ana e vetë të akuzuarit, paratë e gjetura janë në fakt një pjesë e pagesës për kryerjen e vrasjes së S.L.t, që i janë dhënë atij nga H. prej Prishtine aka D. L.

55. Trupi gjykues, duke u bazuar në provat e diskutuara, arrin po ashtu në përfundimin që i akuzuari ka përdorur një mitraloz të tipit PPSH, me numër serie 3B-404, me të cilën ka vrarë N.L.n, pa pasur një leje autorizimi të vlefshëm. Më tej, i akuzuari ka poseduar, po ashtu, edhe armën automatike AK-47, me numër serie 17077519, po ashtu pa pasur një leje autorizimi të vlefshme. I njëjti përfundim aplikohet edhe për 17 plumbat e gjetur të kalibrit 7,62 x 39 mm dhe 56 plumbat e kalibrit 7,62 mmx25mm. Vetë i akuzuari pranon që të ketë qenë në posedim të kësaj të fundit dhe që ka poseduar dhe përdorur mitralozin e tipit PPSH, me numër serie 3B-404, gjë kjo që tashmë është përcaktuar tërësisht. Që të dyja armët janë gjetur në vendin që i ka treguar i akuzuari policisë gjatë marrjes në pyetje prej tyre. Nëse armët nuk do t'i kishin përkitur të akuzuarit, ai nuk do ta dinte se ku ndodheshin ato. Trupi gjykues, për asryet e diskutuara më sipër, nuk e ka besuar që personi i aluduar A. ekzistonte dhe e konsideron këtë thjeshtë vetëm një strategji

mbrojtjeje të të akuzuarit, me qëllim që të shfajësojë veten. I akuzuari nuk ka paraqitur kurrë apo nuk ka treguar kurrë që ka qenë në posedim të një lejeje autorizimi të vlefshme për të mbajtur njëren ose të dyja armët.

56. Trupi gjykues vë re, po ashtu, se i akuzuari ka qenë plotësisht i vetëdijshëm nga ana mendore dhe se ka pasur kontroll mbi veprimet e tij kur i ka kryer këto akte. Nuk ka asnjë të dhënë se kjo mund të çojë në një përfundim tjetër. Mbrojtja gjatë gjykimit kryesor nuk ka ngritur ndonjë kundërshtim të tillë. Gjatë fazës paraprake, mbi të akuzuarin është kryer një analizë psikiatrike, e cila arriti në përfundimin se i akuzuari nuk manifestonte ndonjë çrregullim mendor të ndonjë natyre në kohën e ngjarjeve që kanë çuar në ngritjen e aktakuzës në fjalë.<sup>16</sup>

57. Po ashtu, duke u bazuar në të gjitha provat e paraqitura gjatë gjykimit kryesor, të vlerësuara veç e veç dhe së bashku, trupi gjykues konkludon që faktet e listuara në paragrafin 26 më sipër, si të provuara. Pasojat ligjore të gjendjes faktike të përcaktuar do të diskutohen më poshtë, nën titullin – Përfundimet Ligjore.

## **6.2. Faktet dhe analizat që kanë të bëjnë me veprën penale të Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm (Të akuzuarit L.Q. dhe R.P.)**

*(Faktet e provuara dhe të paprovuara)*

58. Trupi gjykues konsideron se prokuroria nuk ka mundur të provojë faktet e mëposhtme të përmendura në aktakuzën kundër të akuzuarve L.Q. dhe R.P.:

(1) Që më datën 10 janar 2008, në Rrugën “Hafik Zejnullahi”, Komuna e Vushtrisë, L.Q. i vuri zjarrin një automjeti Mercedes C220 CDI, me numër targe 507-KS-681, pronë e palës së dëmtuar A.A., sipas premtimit të R.P.t për t’i paguar atij 3.500 euro, duke marrë një bidon naftë të mbushur me naftë në stacionin e benzinës P., dhe duke shkuar më pas në oborrin e shtëpisë së palës së dëmtuar, aty ku ishte parkuar makina, duke e spërkatur atë me naftë, duke i vënë zjarrin dhe duke u larguar me vrap nga vendi i ngjarjes, duke kryer me këtë veprën penale të Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm.

(2) Më 10 janar 2008, në Rrugën “Hafik Zejnullahi”, Komuna e Vushtrisë, R.P. ka nxitur kushëririn e tij, L. Q. për të kryer një vepër penale, duke i premtuar atij një shumë prej 3.500 euro, në shkëmbim të djegies së automjetit Mercedes C220 CDI, numër targe 507-KS-681, pronë e palës së dëmtuar A.A..

*(Analizë)*

59. Është e pakundërshtueshme se më datën 10 janar 2008, në orët e para të mëngjesit, automjeti Mercedes Benz C 220 CDI, me numër targe 507-KS-681, pronë e A.A.t, është

---

<sup>16</sup> Shih Raportin e Klinikës Psikiatrike, te dates 4 gusht 2011, Dosja e Gjykatës 1, pp. 1-13.

djegur përpara shtëpisë së pronarit në Vushtri. Trupi gjykues i referohet në veçanti Raportit të Ekzaminimit të Vendit të Ngjarjes, të datës 10 janar 2008.<sup>17</sup>

60. Dëshmitari H. S., oficer i policisë, ishte në shërbim së bashku me palën e dëmtuar në mbrëmjen kur u dogj automjeti. Kur u mor në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëshmitari dëshmoi se pa një Renault blu me dy persona brenda. Ai e njohu kerrin si kerri i R.P.t. Automjeti i ngjalli dyshim, sepse në atë kohë në rrugë nuk kishte trafik. Ai e pa automjetin afërt pompës së gazit P..

61. Trupi gjykues arrin në përfundimin se të dy të akuzuarit në Renault Twingo automjeteve gjendeshin vërtet në afërsi të vendit të ngjarjes natën e djegies së kerrit, por nuk ka asnjë dëshmi përfundimtare që lidh ndonjërin prej tyre me djegien e veturës.

62. I akuzuari L.Q. u mor në pyetje katër herë në lidhje me ngjarjet që shkaktuan ngritjen e kësaj akuze, domethënë, më 10 janar 2008 dhe përsëri më 12 prill 2010. Më 5 janar 2011 i akuzuari u mor në pyetje nga prokurori publik dhe në atë kohë deklaroi se i përmbahej deklaratës së dhënë më 12 prill 2010. I akuzuari gjithashtu iu përgjigj pyetjeve të palëve dhe të trupit gjykues në lidhje me këtë vepër penale gjatë shqyrtimit gjyqësor më 8 nëntor 2012.

63. Në deklaratën e tij të parë i akuzuari Q. e mohoi përfshirjen në ndonjë mënyrë në djegien e automjetit dhe bëri të njëjtën gjë gjatë shqyrtimit gjyqësor më 8 nëntor 2012. I akuzuari deklaroi se erdhi për të takuar kushëririn e tij (që ai e quan axhë), R.P., për t'i kërkuar ta dërgonte me automjet në Shkup, ku ai do të shkonte në ambasadën suedeze. Kur ata ishin në rrugë, policia i ndaloi dhe i arrestoi ata në lidhje me djegien e automjetit të A.A.t. I akuzuari përsëriti disa herë se R.P. nuk i ofroi kurrë para për të djegur veturën e A., e as ai në fakt nuk e dinte se ku ndodhej shtëpia e A.A.t.

64. I akuzuari u ballafaqua me deklaratën e tij të 12 prillit 2010, ku ai në fakt kishte deklaruar se ishte ai që kishte djegur automjetin e A.A.t në janar 2008 dhe në fakt paraqiti disa hollësi në lidhje me veturën – d.m.th. markën, llojin, ngjyrën. Ai deklaroi se R.P. i premtoi atij 3.000,00 euro për ta bërë këtë, për shkak të grindjeve mes dy familjeve. Gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari argumentoi se ishte nën presion për të dhënë deklaratë të tillë dhe përsëri u mbrojt duke deklaruar se nuk ishte përfshirë në veprën penale në asnjë mënyrë.

65. Gjatë kësaj procedure penale, i akuzuari R.P. u intervistua dy herë. Ai dha një deklaratë para prokurorit publik më 25 tetor 2010 dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor më 8 nëntor 2012. I akuzuari P. mohoi çdo përfshirje në djegien e automjetit të A.A.t. Ai në thelb vërtetoi dëshminë e të bashkakuazarit Q., të dhënë më 10 janar të vitit 2008 dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor më 8 nëntor 2012. Domethënë, se L.Q. shkoi ta takonte atë një natë para 10 janarit 2012, se ata kishin ngrënë darkë, kishin qëndruar në pompën e gazit P. dhe pastaj në mëngjes herët, në 10 janar 2008, ishin nisur për në Vushtrri, kishin

---

<sup>17</sup> Dosja e Gjykatës 1, Treguesi I, pp. 121-122 A. Shih po ashtu Albumin Fotografik të hartuar më datën 10 janar 2008, Dosja e Gjykatës 1, Treguesi I, pp. 131-147.

ndaluar në fshatin Obranc dhe pastaj kishin vazhduar për në Shkup. Pikërisht atëherë u ndaluan dhe u arrestuan nga Policia.

66. I dëmtuari A.A., i marrë në pyetje si dëshmitar gjatë shqyrtimit gjyqësor më 17 korrik 2012, deklaroi se ndërsa ishte në shërbim më 10 janar 2008 ai mori një telefonatë nga vajza e tij, që i tregoi se automjeti i tij përpara shtëpisë ishte në flakë. Ai u kthye menjëherë në shtëpinë e tij, informoi të gjitha njësitë e në patrullë të blloktonin rrugët për në Vushtrri dhe nga Vushtrria dhe të kontrollonin të gjithë personat e dyshuar. Kur hyri në rrugën H. Z., ai vuri re një Renault Twingo që po vinte nga ajo rrugë dhe po shkonte në drejtim të Prishtinës. Ai pa dy persona në automjet.

67. G.A., e bija e të dëmtuarit, kur u mor në pyetje si dëshmitar gjatë shqyrtimit gjyqësor në 10 korrik 2012, deklaroi se ishte në shtëpi në kohën e ngjarjes. Ajo ishte gjithashtu personi që i telefonoi babait të saj se automjetit i ishte vënë zjarri. Ajo dëgjoi një shpërthim dhe pa se kur kishte nisur zjarri, kishte marrë flakë dhe gjithë automjeti po digjej menjëherë. Ajo nuk kishte parë askënd në afërsi të automjetit.

68. Është e pakundërshtueshme se dy të akuzuarit ishin në afërsi në natën e 10 janarit 2008, kur u dogj automjeti i të dëmtuarit A.A., mirëpo nuk ka asnjë provë përfundimtare që t'i lidhë të dy të akuzuarit me vendin konkret të krimit dhe me veprën penale. Fakti se ata ishin në afërsi nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se ata ishin përgjegjës për djegien e automjetit. Aq më tepër, sepse ata të dy dhanë të njëjtin shpjegim se pse u takuan, si e kaluan mbrëmjen dhe për ku po udhëtonin.

69. Trupi gjykues vëren se vetmja provë që i lidh të dy të akuzuarit me këtë veprë penale është deklarata e L. Q., dhënë më 12 prill 2010, kur ai deklaroi se i vuri zjarrin automjetit dhe se R.P. i premtoi atij para për ta bërë këtë. I akuzuari, megjithatë, në deklaratën e tij të parë në 10 janar 2008 e mohoi këtë, siç bëri në deklaratën e tij më vonë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

70. Trupi gjykues arrin në përfundimin se, në mungesë të ndonjë prove tjetër vërtetuese në deklaratën e L. Q. më 12 prill 2010 dhe në veçanti duke vënë në dukje deklaratat kontradiktore të L. Q. – ku gjatë shqyrtimit gjyqësor ky i fundit e mohoi kategorikisht çdo përfshirje në djegien e automjetit - nuk është provuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale të ngritur në aktakuzë.

71. Trupi gjykues në këtë drejtim gjithashtu i referohet nenit 157 paragrafi (2) të KPPK-së, që përcakton se Gjykata nuk e gjen fajtor të akuzuarin bazuar vetëm, ose në masë vendimtare, në deklaratat e dhëna në polici ose para prokurorit publik.

## **7. GJETJET LIGJORE TË GJYKATËS**

### **7.1. Gjetjet ligjore në lidhje me veprën penale të *vrasjes së rëndë* (i akuzuari L.Q.)**

72. Siç u diskutua nën 6.1. më lart, trupi gjykues konstatoi se i akuzuari L.Q. privoi nga

jeta N.L.n duke e qëlluar atë me armë në 3 gusht 2010. I akuzuari ka kryer vrasje, duke besuar se viktima ishte në fakt S.L., në këmbim të marrjes së shumës së 30.000,00 eurove, siç ishte rënë dakord me një farë H. nga Prishtina, pseudonimi D. L.

73. Prandaj i akuzuari ka kryer veprën penale të *vrasjes së rëndë*, në shkelje të nenit 147 pika 7) të KPK-së. Kjo veprë penale është kryer nga një person i cili privon nga jeta personin tjetër për qëllim të sigurimit të një përfitimi pasuror. Të gjitha elementet e kësaj vepre penale janë vërtetuar siç u elaborua më sipër.

74. Në bazë të nenit 11 paragrafi (1) të KPK-së, një person është penalisht përgjegjës nëse ai është mendërisht i aftë dhe është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale. Në bazë të dispozitës së njëjtë, një person është fajtor për kryerjen e një vepre penale, kur ai kryen një veprë penale me dashje apo nga pakujdesia.

75. Së pari, nuk ka asnjë dyshim lidhur me faktin se i akuzuari ishte mendërisht plotësisht i aftë kur e kreu veprën penale. Asgjë në shkresat e lëndës nuk sugjeron ndryshe dhe asnjë kundërshtim i tillë nuk u ngrit nga Mbrojtja.

76. Së dyti, i akuzuari, kur kreu krimin, veproi me dashje të drejtpërdrejtë.

77. Një veprë penale mund të kryhet me dashje të drejtpërdrejtë ose të rastit. Një person vepron me dashje të drejtpërdrejtë kur është i ndërgjegjshëm për aktin dhe dëshirat e tij në kryerjen e krimin. I akuzuari donte të privonte nga jeta një person, u përgatit për këtë për disa muaj dhe bëri plane të gjera, në mënyrë që të kryente vrasjen. Më tej, i akuzuari i qëllloi viktimën shumë herë me mitraloz, cka tregon se ai ishte i vendosur ta vriste këtë person.

78. Trupi gjykues rithekson se fakti që i akuzuari kujtoi se qëlloi S.L.nuk ka vend në këtë rast. Gabimi në fakt do ta shfajësonte të akuzuarin nga përgjegjësia e tij vetëm nëse karakteristika do të kishte qenë e një natyre të tillë që do ta bënte aktin të lejueshëm. Domethënë, në bazë të nenit 18 të KPK-së, një person nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale, ai nuk është i ndërgjegjshëm për një karakteristikë të atij akti ose nëse ai gabimisht besonte se ekzistonin rrethana që, po të kishin ekzistuar në fakt, do të kishin bërë të lejueshëm aktin.

79. Rrjedhimisht, trupi gjykues e gjeti të akuzuarin fajtor për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, në shkelje të nenit 147 Pika 7) të KPK-së, dhe e gjeti të akuzuarin penalisht përgjegjës për veprën penale në fjalë.

## **7.2. Gjetjet ligjore lidhur me veprën penale të *mbajtjes së armëve pa leje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim* (L.Q.)**

80. Vepra penale e *mbajtjes pa leje të armëve në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim*, në shkelje të nenit 328 paragrafi (2) të KPK-së kryhet nga kushdo që zotëron, kontrollon, posedon ose përdor armë pa leje të vlefshme armëmbajtjeje për atë armë. Të gjitha elementet e kësaj vepre penale janë vërtetuar, sic u elaborua më sipër nën 6.1.

81. I akuzuari gjithashtu në lidhje me këtë vepër penale ishte mendërisht plotësisht i aftë dhe veproi me dashje të drejtpërdrejtë. I akuzuari e dinte se mbajtja e armëve pa lejen e duhur është e ndaluar, por ai vazhdoi ta bëjë këtë për një periudhë më të gjatë kohore. Kjo edhe pasi një armë i është konfiskuar atij nga policia, siç pranoi ai vetë.

82. Rrjedhimisht, trupi gjykues e gjen të akuzuarin fajtor për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim, në shkelje të nenit 328 paragrafi (2) të KPK-së, dhe e gjen të akuzuarin penalisht përgjegjës për veprën penale në fjalë.

### **7.3. Gjetjet ligjore në lidhje me veprën penale të *shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm* (të akuzuarit L.Q. dhe R.P.)**

83. Vepra penale e *shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm*, në shkelje të nenit 291 paragrafi (1) të KPK-së e kryer nga kushdo që, duke përdorur zjarrin, përmbytjen, armë, eksplozivë, helm ose gaz helmues, me jonizim të rrezatimit, forca mekanikës, energjisë elektrike, ose çdo lloji tjetër të energjisë, u shkakton rrezik të madh jetës së njerëzve ose pasurisë me vlerë të konsiderueshme, dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

84. Siç u elaborua më lart nën 6.2., trupi gjykues nuk i gjeti të provuara faktet që sollën ngritjen e kësaj akuze kundër të akuzuarve L.Q. dhe R.P.. Rrjedhimisht, trupi gjykues i liroi të dy të akuzuarit nga kjo vepër penale, në bazë të nenit 390 pika 3) të KPPK-së.

## **8. DËNIMI**

85. Kur shqyrtoi dënimin, trupi gjykues mori parasysh qëllimet e dënimit, siç parashihet në nenin 34 të KPK-së, domethënë, parandalimi, rehabilitimi dhe frenimi. Gjithashtu trupi gjykues eksplori dhe shqyrtoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese në lidhje me secilën vepër penale, në përputhje me nenin 64 paragrafi (1) të KPK-së, si dhe faktin që dënimi i shqiptuar duhet të jetë në përpjesëtim me peshën e veprës dhe sjelljen dhe rrethanat e kryerësit.

86. I akuzuari Q. u gjykua dhe u dënua për dy vepra penale. Në bazë të nenit 71 paragrafi (1) të KPK-së, trupi gjykues në fillim shqiptoi dënimin për çdo vepër penale dhe pastaj shqiptoi dënimin unik në përputhje me nenin 71 paragrafi (2) pika 2) të KPK-së.

87. Në bazë të nenin 147 pika 7) të KPK-së, vepra penale e *vrasjes së rëndë* dënohet me burgim prej së paku dhjetë vjet, ose me burgim afatgjatë. Në bazë të nenit 38 të KPK-së, maksimumi i përgjithshëm i përcaktuar me ligj është njëzet vjet burgim dhe dënimi me burgim shqiptohet në vite të plota dhe muaj të plotë. Dënimi me burgim afatgjatë është burgim për një afat prej 21 deri në 40 vjet, në bazë të nenit 37 të KPK-së.

88. Trupi gjykues, ikur përcaktoi dënimin për këtë vepër penale, mori parasysh rrethanat e mëposhtme përmbledhëse, kryesisht lidhur me mënyrën në të cilën u krye vepra penale.

Trupi gjykues konsideroi si rrethanë rënduese faktin që viktimi u kap tërësisht në befasi, duke e bërë çdo reagim apo mbrojtje të pamundur; dhe faktin që i akuzuari e qëlloni në oborrin e vet. Më tej, i akuzuari rrezikoi njerëzit e të tjerë duke shtënë mbi viktimën përpara shtëpisë së tij dhe duke qenë i vetëdijshëm për praninë e personave të tjerë, domethënë, dy gra në automjet. I akuzuari rrezikoi kështu jetën e këtyre dy personave. Trupi gjykues konsideroi si rrethanë rënduese edhe faktin se i akuzuari e kishte planifikuar veprën penale për një periudhë më të gjatë kohore, përkatësisht disa muaj, dhe në të gjithë atë kohë ai nuk u tërhoq kurrë nga kryerja e veprës penale. Sa u përket rrethanave lehtësuese, trupi gjykues mundi të identifikojë vetëm një, d.m.th. se i akuzuari nuk ka dënime të mëparshme (të identifikuar).

89. Duke pasur parasysh se rrethanat rënduese peshojnë më shumë se ato lehtësuese dhe duke marrë parasysh të gjitha qëllimet e dënimit të përshkruara më lart, trupi gjykues konsideron se një dënim prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vjetësh burgim është dënimi i përshtatshëm për veprën penale të kryer.

90. Vepra penale e *mbajtjes pa leje të armëve në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim*, në shkëlqje të nenit 328 paragrafi (2) të KPK-së, dënohet me gjobë deri në 7,500 euro, ose me burgim prej një deri në tetë vjet.

91. Trupi gjykues gjeti se ekziston e njëjta rrethanë lehtësuese edhe për këtë vepër penale, d.m.th. se i akuzuari nuk ka historik penal. Trupi gjykues e identifikoi këmbënguljen edhe për këtë vepër penale si rrethanë rënduese. I akuzuari pranoi pikërisht se kishte pasur në zotërim armë për disa muaj dhe madje edhe i kishte zëvendësuar ato pasi u ndalua nga Policia dhe iu konfiskuan armët. Më tej, numrin dhe llojin e armëve për posedimin e të cilave i akuzuari u shpall fajtor, trupi gjykues e mori si rrethanë rënduese. I akuzuari, domethënë, kishte jo një, por dy armë, funksioni dhe konfigurimi i të cilave është veçanërisht i rëndë (nganjëherë të quajtura 'armë lufte').

92. Duke pasur parasysh se rrethanat rënduese peshojnë më shumë se ato lehtësuese dhe duke marrë parasysh të gjitha qëllimet e dënimit të përshkruara më lart, trupi gjykues konkludoi se dënimi8 prej 4 (katër) vjetësh burg është dënim i përshtatshëm për veprën penale të kryer.

93. Në bazë të nenit 71 paragrafi (2) pika 2) të KPK-së, nëse është shqiptuar dënim me burgim për secilën vepër penale, dënimi unik duhet të jetë më i lartë se çdo dënim individual, por dënimi unik nuk mund të jetë aq i lartë sa shuma e të gjitha dënimeve të shqiptuara, as mund të kalojë një periudhë prej njëzet vjetësh. Në përputhje me këtë dispozitë, trupi gjykues vendosi që dënimi unik i shqiptuar ndaj të akuzuarit të jetë 19 (nëntëmbëdhjetë) vjet burgim.

94. I akuzuari u arrestua më 7 gusht 2010 dhe që atëherë ka qenë në paraburgim, prandaj kjo kohë duhet të përfshihet në dënimin me burgim, në bazë të nenit 73 paragrafët (1) dhe (4) të KPK-së.



## ÇËSHITJE TË TJERA

### **9. KONFISKIMI**

95. Në bazë të nenit 60 paragrafi (1) të KPK-së dhe nenit 328 paragrafi (5) të KPK-së, trupi gjykues urdhëroi konfiskimin e armëve dhe municionit, domethënë, të armës automatike AK-47, me numër serik 17077519 dhe 17 fishekë të kalibrit 7,62 x 39 mm, dhe një mitraloz të tipit PPSH, me numër serik 3B-404 dhe 56 fishekë të kalibrit 7,62 x 25 mm.

96. Trupi gjykues urdhëroi gjithashtu konfiskimin e automjetit Opel Omega me tablla numër 132-KS-788, në bazë të nenit 60 paragrafi (1) të KPK-së.

97. Në bazë të së njëjtës dispozite (neni 60 paragrafi (1) i KPK-së) trupit gjykues urdhëroi më tej konfiskimin e parave të konfiskuara përkohësisht nga L.Q. në kohën e arrestimit, d.m.th. 3.300,00 euro.

### **10. SHPENZIMET**

98. I akuzuari L.Q. u gjet fajtor për dy vepra penale dhe në bazë të nenit 102 të KPPK-së ai duhet të mbulojë shpenzimet e procedurës penale. Trupi gjykues mori parasysh se i akuzuari u lirua nga njëra akuzë dhe kështu nuk është përgjegjës për mbulimin e shpenzimeve në lidhje me këtë akuzë.

99. Për shkak të gjendjes të tij të dobët ekonomike, i akuzuari Q. u urdhërua të paguajë vetëm një pjesë të shpenzimeve në shumën 400,00 euro. Trupi gjykues vendosi ta lehtësojë të akuzuarin nga detyrimi për të paguar pjesën e mbetur të shpenzimeve, në bazë të nenit 102 paragrafët (1) dhe (4) të KPPK-së.

100. Për shkak se i akuzuari R.P. u lirua nga akuza penale kundër tij, shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 99 paragrafi (2) nën-paragrafët 1) deri në 5) të KPPK-së, shpenzimet e nevojshme të të akuzuarit dhe shpërblimi dhe shpenzimet e nevojshme të Mbrojtjes së tij u urdhërua të paguhesh nga mjetet buxhetore, në bazë të nenit 103 paragrafi (1) të KPPK-së.

### **11. PADIA PËR KOMPENSIM**

101. I dëmtuari B.L. u udhëzua që paraqesë padi pasurore në kontest civil në bazë të nenit 112 paragrafi (2) të KPPK-së.

102. Gjatë shqyrtimit kryesor A.A. nuk paraqiti kërkesë për kompensim.

Për këto arsye vendoset si në dispozitiv.

Hartuar në anglishte, gjuhë e autorizuar

Kryetar i trupit gjykues

---

Nuno Manuel Ferreira de MADUREIRA  
Gjyqtar i EULEX-it

Proces-mbajtëse

---

Beti HOHLER  
Oficer ligjor i EULEX-it

**MJET JURIDIK:**

*Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë kundër këtij Aktgjykimi brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit tek këta persona të një kopjeje të autorizuar të tij. (Neni 398 i KPPK-së). Ankesa duhet të dorëzohet Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë dhe do të vendoset nga Gjykata e Shkallës së Dytë.*